

Vendim nr. 84 datë 18.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 18.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (B) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BLENDAR LIKAJ**, përfaqësuar nga avokat Atmir Mani, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 231, datë 30.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; nr. 30-2023-3956 (1080), datë 13.07.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2023-1643, datë 17.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 28.05.2023, rreth orës 01:30, shërbimet e Drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë, ndërkohë që ishin të stacionuar me shërbim në fshatin Borsh të Bashkisë Himarë, për të siguruar mbarëvajtjen e një aktiviteti kulturor, kanë konstatuar katër persona, të cilët, pas afrimit të punonjësve të policisë, janë larguar me shpejtësi. Dy prej tyre kanë tentuar të largohen me një automjet që është ndaluar nga punonjësit e policisë. Pas kontrollit të ushtruar, në ndenjësen e pasme të automjetit, në një çantë, është gjetur një armë zjarri tip pistoletë, si dhe një krehër fishekësh rezervë. Drejtuesi i automjetit, i identifikuar si shtetasi Bledar Likaj (*kërkuesi*), u ka deklaruar punonjësve të policisë se arma i përkiste atij dhe se atë e mbante me leje. Nga verifikimi i autorizimit të paraqitur ka rezultuar se ai i përkiste asaj arme, por mbajtja i lejohej vetëm në banesën e deklaruar në Tiranë. Në këto kushte, oficeri i Policisë Gjyqësore ka bërë arrestimin në flagrancë të kërkuesit për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i Kodit Penal (KP). Materialet më pas i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e cila ka regjistruar procedim penal kundër kërkuesit për veprën penale të sipërpërmendur. Në vijim, prokurori i ka kërkuar gjykatës vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të kërkuesit, sikundër edhe caktimin ndaj tij të masës shtrënguese të sigurimit “Arresti në shtëpi”.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 231, datë 30.05.2023, ka vendosur të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit. Po kështu, ajo ka caktuar ndaj tij si masë sigurimi “Detyrimin për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, ndërsa ka urdhëruar lirim të menjëhershëm. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, duke pretenduar se nuk ka kryer ndonjë vepër penale, prandaj arrestimi në flagrancë dhe caktimi ndaj tij i një mase sigurimi ishin të paligjshëm.

3. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 30-2023-3956 (1018), datë 13.07.2023, ka vendosur miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, qoftë për sa i përket vleftësimit të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të kërkuesit, ashtu edhe në lidhje me caktimin e masës shtrënguese të sigurimit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1643, datë 17.10.2023, ka vendosur mospranimin e tij,

me arsyetimin se shkaqet e parashtruara në rekurs janë haptazi të pabazuara, ndërsa gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin në raport me gjendjen në të cilën paraqitet procedimi penal.

5. Në datën 16.02.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit 8577/2000, është regjistruar në datën 26.02.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

6.1 *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

6.1.1 *Së drejtës për t'u mos u akuzuar dhe arrestuar mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të garantuar nga neni 32 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë vlerësuar në mënyrë të gabuar faktet dhe provat, ndërsa nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm për kryerjen nga kërkuesi të veprës penale, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së dhe se ato me keqdashje kanë keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr. 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar (*ligji nr. 74/2014*) që rregullon mbajtjen e armëve me leje të organeve kompetente.

6.1.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, nuk ka arsyetuar për pretendimet e ngritura në rekurs, duke mos bërë dallimin mes shkeljes administrative dhe asaj penale. Mbajtja e armës jashtë banese nuk përbën veprë penale, por kundërvajtje administrative, duke qenë se kërkuesi kishte leje për mbajtjen e saj në banesë.

6.2 *E drejta për lirinë personale*, e garantuar nga neni 28 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit, arrestim i cili është bërë në kundërshtim me nenet 251, 252 dhe 254 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), për sa kohë nuk jemi para një veprë penale, por përpara një kundërvajtjeje administrative, në rrethanat kur armën që i është gjetur në automjet ai e mbante me leje të organit kompetent.

6.3 *E drejta për lirinë e lëvizjes*, e garantuar nga neni 38 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë caktuar ndaj kërkuesit një masë sigurimi në kundërshtim me nenet 228 dhe 229 të KPP-së, për sa kohë mungon dyshimi i arsyeshëm për kryerjen nga ai të veprës penale që i është atribuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

8. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, i cili mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se objekt kundërshtimi nga kërkuesi është vendimi gjyqësor i gjykatës së shkallës së parë që kanë disponuar: (i) për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit të tij në flagrancë; (ii) dhe për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, vendim i cili është miratuar nga gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësit. Për sa u takon masave të sigurimit personal, ato për nga natyra e tyre janë vendimmarrje jo përfundimtare, në kuptimin që nuk vendosin në lidhje me (pa)fajësinë e të pandehurit. Po kështu, ato janë të

ndryshueshme dhe të revokueshme. Prandaj, për të konkluduar nëse ankimi kushtetues individual i kërkuesit mund të merret në shqyrtim nga Gjykata, Kolegji vlerëson se është me rëndësi të përcaktohet nëse vendimet e procesit gjyqësor të kundërshtuara kanë natyrë përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

11. Gjykata ka bërë, rast pas rasti, vlerësimin nëse për shkak të natyrës së veçantë të çështjes që shtrohet përpara saj për shqyrtim ka vend për përjashtim nga rregulli i natyrës përfundimtare të vendimit objekt i ankimit kushtetues individual. Sipas saj, vendimet e ndërmjetme mund të bëhen pjesë e juridiksionit kushtetues në rast se plotësohen këto kushte: (i) shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm është bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta janë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm ka një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në jurisprudencën e saj, në lidhje me vendimet gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit personal, ndërsa ka pranuar se ato janë vendime të ndërmjetme, Gjykata është shprehur se vetëm vendimet për caktimin e masës së arrestit, si përjashtim, konsiderohen përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, vendimet për caktimin e masës së sigurimit të arrestit konsiderohen përfundimtare për qëllimet e kontrollit kushtetues, duke qenë se lidhen me heqjen e lirisë së individit (*shih vendimet nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke pasur si pikënisje këtë qëndrim, Gjykata ka pohuar se edhe vendimet gjyqësore për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë, pavarësisht heqjes së lirisë për një kohë të shkurtër, iu nënshtrohen të njëjtave standarde dhe kritere kushtetuese si në rastin e masës së sigurimit të arrestit, duke i konsideruar ato përfundimtare për efekt të kontrollit kushtetues (*shih vendimin nr. 52, datë 08.04.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se masa shtrënguese e sigurimit e caktuar ndaj kërkuesit është e ndryshme nga ajo e arrestit dhe nuk i ka privuar atij lirinë. Nga kërkuesi pretendohet se ajo masë i kufizon lirinë e lëvizjes, megjithëse shtrëngimi që ajo përmban konsiston në detyrimin e tij për t’u paraqitur në ditë të caktuara (një herë në muaj) para autoriteteve të ndjekjes penale. Në këtë këndvështrim, duke mbajtur në konsideratë dhe jurisprudencën kushtetuese, vendimet gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi për sa u përket

urdhërimeve për masën e sigurimit, nuk janë përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj ato për këtë pjesë nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

14. Nga ana tjetër, vendimet gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi, për sa u përket urdhërimeve për ligjshmërinë e masës së arrestit në flagrancë përmes së cilës atij i është hequr liria, kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive plotësohet, ndërsa ato për këtë pjesë konsiderohen përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

15. Kolegji konstaton se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 17.10.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 16.02.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar liria personale dhe e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për të mos u akuzuar dhe arrestuar mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe të standardit të arsyetimit të vendimit. Bazuar në përmbajtjen dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato do të analizohen në vijim në këndvështrim të garancisë procedurale të lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të shqyrtohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore

17. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e lirisë personale, pasi gjykatat kanë vleftësuar të ligjshëm arrestimin e tij në flagrancë, arrestim ky që është bërë në kundërshtim me nenet 251, 252 dhe 254 të KPP-së, për sa kohë nuk gjendemi para një veprë penale, por përpara një kundërvajtjeje administrative. Sipas tij, gjykatat kanë vlerësuar në mënyrë të gabuar faktet dhe provat, ndërsa nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm për kryerjen nga ai të veprës penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së dhe se gjykatat, me keqdashje, kanë keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr. 74/2014 që rregullon mbajtjen e armëve me leje të organeve kompetente. Po kështu, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, nuk ka arsyetuar për pretendimet e ngritura në rekurs, duke mos bërë dallimin mes shkeljes administrative dhe asaj penale. Mbajtja e armës jashtë banesë, sipas kërkuesit, nuk përbën vepër penale, por kundërvajtje administrative, duke qenë se ai kishte leje për mbajtjen e saj në banesë.

18. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund

të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja "c"*). Ndërsa sipas nenit 28 të Kushtetutës, personit të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, shkronja "c", duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij.

19. Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit të brendshëm dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të përmbushë standardin e "*ligjshmërisë*" të përcaktuar nga KEDNJ-ja, një standard i cili kërkon që ligji të jetë mjaftueshëm i qartë për t'i mundësuar individit që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme, rrethanat dhe pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 39, datë 15.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kushtet, kriteret dhe procedurat për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Liria personale mbrohet edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, sipas të cilit "dyshimet e arsyeshme" për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën akuzohet (*shih vendimin nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) është shprehur se nëse një person ndalohet në bazë të nenit 5, paragrafi 1, shkronja "c", të KEDNJ-së, "gjykata" duhet të jetë e autorizuar të shqyrtojë nëse ka ose jo prova të mjaftueshme për të krijuar një dyshim të arsyeshëm se individi ka kryer një veprë penale, pasi ekzistenca e një dyshimi të tillë është thelbësore nëse burgimi duhet të jetë "i ligjshëm", sipas KEDNJ-së (*shih Dimo Dimov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2020, § 70*). Gjithashtu, ajo është shprehur se në rastin e një personi të ndaluar, sipas nenit 5, paragrafi 1, shkronja "c", kërkohet zhvillimi i një

seancë dëgjimore (*shih Nikolova kundër Bullgarisë [GC], 1999, § 58*). Mundësia që një i ndaluar të dëgjohej personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi është një nga garancitë themelore të procesit (*shih Kampanis kundër Greqisë, 1995, § 47*), proces i cili duhet të jetë kontradiktor dhe të garantojë “barazinë e armëve” ndërmjet palëve (*shih Reinprecht kundër Austrisë, 2005, § 31; A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], 2009, § 204*). Çështja nëse gjykimi është bërë “brenda një afati të shpejtë” përcaktohet nën dritën e rrethanave të secilit rast (*shih Ilmseher kundër Gjermanisë [GC], 2018, § 252; Rehbock kundër Sllovenisë, 2000, § 84*) dhe afati konsiderohet nga momenti i paraqitjes së kërkesës deri në përcaktimin e ligjshmërisë së ndalimit, duke përfshirë këtu çdo ankim (*shih Sanchez-Reisse kundër Zvicrës, 1986, § 54; E. kundër Norvegjisë, 1990, § 64*). Në bërjen e një vlerësimi të tillë, rrethanat që duhen marrë parasysh përfshijnë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e autoriteteve vendase dhe të kërkuesit, çfarë paraqet rrezik për këtë të fundit (*shih Ilmseher kundër Gjermanisë [GC], 2018, § 252*).

22. Për sa i përket legjislacionit të zbatueshëm, në rastin në shqyrtim, në lidhje me arrestimin në flagrancë, sipas nenit 251 të KPP-së, oficerët dhe agentët e Policisë Gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet. Ndërkohë, është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale (*neni 252*). Ndërsa, neni 258, pika 1, ka përcaktuar detyrimin e prokurorit për të kërkuar vleftësimin e masës së arrestit në flagrancë në gjykatën e rrethit ku është kryer arrestimi, nëse brenda 48 orëve nga arrestimi nuk ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të personit të arrestuar.

23. Duke pasur parasysh standardet e mësipërme kushtetuese dhe konventore, Kolegji do të vlerësojë nëse për heqjen e lirisë personale të kërkuesit ka pasur dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, nëse heqja e saj është bërë sipas procedurave të parashikuara nga ligji dhe nëse gjykatat që kanë vleftësuar masën e arrestimit në flagrancë, mbi bazën e ankimit të kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshëmrisht nga pikëpamja kushtetuese vendimet e tyre në këtë drejtim.

24. Kolegji vëren se punonjësit e policisë e kanë kapur kërkuesin larg vendbanimit të tij, duke mbajtur në automjet një armë zjarri “tip pistoletë”, për të cilën ishte i pajisur nga organi kompetent me autorizim për mbajtjen e saj në vendbanim, vetëm në banesë, me kufizim të plotë për nxjerrjen e armës jashtë saj. Nisur nga kjo, duke konsideruar se mbajtja jashtë banesës e

armës së zjarrit nga kërkuesi, në shkelje të autorizimit administrativ, përbënte veprë penale, në zbatim të nenit 251, pika 1, të KPP-së, oficeri i Policisë Gjyqësore ka bërë arrestimin e tij në flagrancë si autor të veprës penale “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së. Në vijim, materialet i janë referuar prokurorit i cili, ndërsa nuk ka urdhëruar lirimin e kërkuesit brenda 48 orëve nga arrestimi, i ka kërkuar gjykatës së shkallës së parë të vendit ku është kryer arrestimi, vleftësimin e ligjshëm të tij. Kjo e fundit e ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke vlerësuar se, bazuar në të dhënat e mbledhura ekzistonte dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së dhe kishte të dhëna të mjaftueshme se kërkuesi është personi që i atribuohet kjo veprë penale, ndërsa ai është kapur duke mbajtur një armë zjarri në automjet, për të cilën nuk kishte autorizim për mbajtjen e saj jashtë banesës. Po sipas asaj gjykate, arrestimi në flagrancë i kërkuesit nga oficeri i Policisë Gjyqësore është bërë në përputhje me nenet 251 dhe 252 të KP-së, ndërsa ai është kapur në kryerje e sipër të veprës penale me sende dhe prova materiale, nga të cilat dukej se e ka kryer atë.

25. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për sa i përket vleftësimin të ligjshëm të arrestimit të tij në flagrancë, duke arsyetuar se arrestimi në flagrancë i kërkuesit është bërë në përputhje me nenet 251, pika 1 dhe 252 të KPP-së, se nuk ekzistonte ndonjë shkak moslejimi të arrestimit të tij, sipas nenit 254 të KPP-së, dhe se kërkesa e prokurorit ishte paraqitur brenda afatit të përcaktuar në nenin 258 të po këtij kodi. Në lidhje me pretendimin e ngritur në ankimin e kërkuesit se fakti për të cilin akuzohej nuk përbënte veprë penale, gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar në ligj, duke arsyetuar se fakti që ai është i pajisur me autorizim për mbajtjen e armës vetëm në banesë, ndërkohë që jashtë saj mbajtja e armës është e vlefshme vetëm me lejen e policisë, referuar faktit që rezultonte nga provat e administruara deri në atë moment, formohet dyshimi i arsyeshëm për ekzistencën e veprës penale dhe kryerjen e saj nga ai.

26. Në vijim, për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se shkaqet e parashtruara në rekurs janë haptazi të pabazuara. Kolegji Penal e ka vlerësuar të drejtë përfundimin e gjykatave më të ulëta për ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë të kërkuesit. Ai e ka gjetur të pabazuar pretendimin e ngritur në rekurs nga kërkuesi, duke arsyetuar se, me të drejtë, personit nën hetim (kërkuesit) i është atribuar prezenca e një dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278, pika 1, i KP-së, për sa kohë që ai ka rezultuar në disponim të një arme luftarake në një lokalitet bregdetar, duke qenë i paautorizuar për ta mbajtur në të tilla mjedise. Fakti i pajisjes së tij me

leje, autorizim të organit administrativ për të mbajtur armë vetëm në mjediset e banesës, nuk e legjitimon atë për të qarkulluar dhe justifikuar mbajtjen e saj jashtë banesës, çka formëson prezencën, në nivel të dyshimit të arsyeshëm, të faktit penal të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së. Sipas Kolegjit Penal, fakti që kërkuesi ka pasur leje për armën që mbante nuk tregon se jemi para një shkeljeje administrative, pasi shkaku dhe vendi për të cilin ai ka marrë lejen është mbajtja e saj vetëm në banesë, ndërsa referuar nenit 56 të ligjit nr. 74/2014 personat fizikë që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur veprimet e tyre përkatëse nuk përbëjnë vepër penale, janë përgjegjës për kundërvajtje administrative.

27. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se arrestimi në flagrancë i kërkuesit, që është një masë e parashikuar me ligj, është bërë, gjithashtu, duke respektuar procedurat e parashikuara nga ligji (KPP-ja) dhe ligjshmëria e kësaj mase është shqyrtuar nga gjykatat, të cilat kanë dhënë argumentet përkatëse në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të organeve ligjzbatuese. Si gjykata e shkallës së parë, ashtu dhe gjykata e apelit kanë analizuar faktet dhe provat në ngarkim të kërkuesit, sikundër kanë analizuar edhe dispozitat ligjore përkatëse të zbatueshme në atë rast, në raport me kushtet dhe kriteret për gjendjen e flagrancës, e cila ka sjellë kufizimin dhe heqjen e lirisë personale, duke arsyetuar vendimet e tyre, si për sa u takon pretendimeve të tij për ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë, ashtu edhe për sa u përket konkluzioneve të arritura prej tyre për ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale.

28. Në vijim, edhe Gjykata e Lartë, referuar pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, duke verifikuar dhe vlerësuar se vendimet që kanë vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe kufizimin e lirisë personale të kërkuesit janë të drejta. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se vleftësimi i arrestit në flagrancë i kërkuesit dhe kufizimi i lirisë personale të tij nuk rezultojnë të jetë bërë në kundërshtim me nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës, dispozitat e KEDNJ-në, jurisprudencën kushtetuese ose dispozitat ligjore në fuqi dhe se gjykatat e zakonshme kanë mbajtur parasysh garancitë e ofruara nga kuadri kushtetues dhe ligjor në këtë drejtim, duke garantuar edhe respektimin e nenit 142, pika 1, të Kushtetutës në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

29. Kolegji vëren, gjithashtu, se në kuptim të nenit 28, pika 2, të Kushtetutës, në rastin e kërkuesit janë respektuar edhe parashikimet kushtetuese që përcaktojnë afatin për t`u dërguar përpara gjyqtarit dhe për të pasur një vleftësim të masës së heqjes së lirisë. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezultojnë se kërkuesi është arrestuar në datën 28.05.2023 dhe brenda afatit prej 48-orësh ai është dërguar në gjykatë, e cila, po brenda të njëjtit afat nga marrja e dokumenteve, me vendimin e datës 30.05.2023 ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në

flagrancë të kërkuarit. Po kështu, edhe në kuptim të pikës 3 të nenit 28 të Kushtetutës, kërkuarit i është garantuar edhe e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi dhe për të pasur një shqyrtim gjyqësor të pretendimeve të tij në lidhje me arrestimin në flagrancë. Rezulton se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila me vendimin e datës 13.07.2023 e ka miratuar atë dhe, ndërkohë që vendimi i kësaj të fundit ka mbetur i pacenuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë pas vendimit të tij të datës 17.10.2023.

30. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale të lidhur me standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, është haptazi i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.